



trainkos

HEKURUDHAT E KOSOVËS - TRAINKOS SH.A
BORDI I DREJTORËVE

Nr. I/53

Datë: 27.03.2024

Bazuar në Nenin 21 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, duke pasur parasysh edhe Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087, Nenin 162 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, Nenin 26.6 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporatave, Nenin 10, paragrafin 3.2 të Rregullores Nr. I/32 të datës 29.02.2024 për Procedurat e Rekrutimit dhe të Emërimit në Pozitat e Zyrtarëve të Lartë në HK-Trainkos Sh.A, Bord i Drejtorëve i HK-Trainkos Sh.A në Mbledhjen Nr. 06, të mbajtur më 27.03.2024, njëzëri mori këtë:

VENDIM

- I. Për formimin e Komisionit për seleksionimin e kandidatëve në Konkursin e publikuar më 15.03.2024 për pozitën e Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Thesarit, sipas kësaj përbërje:
 - Luljeta Lutfiu, Kryetare e Komisionit;
 - Agron Statovci, anëtar i Komisionit;
 - Arbër Salihu, anëtar i Komisionit.
- II. Detyrë e Komisionit është shqyrtimi i aplikacioneve të pranuar lidhur me plotësimin e kushteve dhe kriterëve të parapara në konkurs dhe seleksionimi i kandidatëve potencialë.
- III. Për çdo aplikacion të refuzuar, Komisioni nxjerr vendim të arsyetuar, shtjellon në detaje shkaqet e refuzimit dhe prezanton elementet tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi për procedurën e përgjithshme administrative.
- IV. Kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e konkursit njoftohen nëpërmjet komunikimit elektronik dhe individualisht për kushtet dhe kriteret e paplotësuara.
- V. Pas shqyrtimit të aplikacioneve, Komisioni harton raportin e punës, përfshirë listën e kandidatëve që i plotësojnë kushtet dhe kriteret e konkursit dhe do t'i propozojë Bordit të Drejtorëve së paku dy prej kandidatëve potencialë për emërim në pozitën e ZKFTH-së.
- VI. Vendimi hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.

Për Bordin e Drejtorëve

Jetmir NUKA – Kryesues

Iu dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit
- Aksionarit – NJPMNP
- Arkivit